



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Botimi 3

BULETINI

I

UDHËZIMEVE TEKNIKE NR.3

(Janar – Qershor 2018)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

TABELA PËRMBLEDHËSE

I. HYRJE.....

II. UDHËZIM TEKNIK - Sqarim lidhur me ndarjen e e veprimtarive ekonomike e për tatimpaguesit që aplikojnë shkallën e reduktuar të T.V.SH-së 6%.

III. RASTE SPECIFIKE TË TATIMPAGUESVE TË TRAJTUARA PËR PROBLEME TË HASURA NË PRAKTIKË.....

1. Nga fusha e procedurave tatimore

1.1 Mbi përdorimin e faturës së shoqërimit gjatë lëvizjes së brendshme të mallrave si dhe lidhur me paajsjen e mjeteve të transportit me Nipt sekondar.

1.2 Mbi dokumentacionin tatimor që duhet të disponojnë organizatat jofitimpruese për llogaritjen, mbajtjen, dhe kontabilizimin e informacionit tatimor.

1.3 Mbi përgjegjësinë tatimore të TVSH-së në bazë të qarkullimit vjetor.

2. Nga fusha e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar

2.1 Mbi përjashtimin nga TVSH-ja për furnizimin e shërbimeve arsimore.

2.2 Mbi saktësinë e vlerës së tatueshme-Rastet e lëshimit të faturës korrigjuese.

2.3 Rastet e përjashtimit nga TVSH-ja për a i përket furnizimit të tokës, ndërtesës dhe dhënia me qira e pasurive të paluajtshme.

3. Nga fusha e ligjit të Tatimit mbi të Ardhurat

3.1 Mbi njohjen si shpenzim i zbritshëm të vlerës së truallit të vënë në dispozicion nga pronari i tokës, sipas kontratave të këmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

3.2 Mbi tatimin që i nënshtrohen të ardhurat e individit në rastin eshpërndarjes së dividendit.

3.3 Rastet kur nuk do të mbahet tatimi në burim.

4. Nga fusha e punësimit dhe sigurimeve Shoqërore

4.1 Rastet e përjashtimit të shtetasve të huaj nga mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

4.2 Mbi të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale- Përjashtimet nga paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

I. HYRJE

Marrëdhëniet ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve rregullohen nëpërmjet dispozitave të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tyre. Këto dispozita saktësojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të tij tregtar. Vlen të theksohet se, prioriteti i administratës tatimore është trajtimi i njëjtë dhe në mënyrë të barabartë i të gjithë tatimpaguesve dhe respektimi korrekt dhe i njëjtë i dispozitave ligjore nga ana e tyre.

Në zbatim të Nenit 10, pika 3 e ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në funksion të marrëdhënies së vazhdueshme administratë tatimore – tatimpagues, si dhe e udhëhequr nga parimet e administrimit tatimor të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, publikon Buletinin Nr.3, në të cilin janë përfshirë sqaruese/orientuese dhe trajtime për raste specifike të adresuara në administratën tatimore nga tatimpagues të ndryshëm që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Ky Buletin vjen si vazhdimësi e Buletineve të mëparshëm të publikuara në website-in e administratës tatimore, në të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në zbatim të detyrave të saj funksionale dhe në trajtim të dhjetëra shkresave dhe kërkesave të tatimpaguesve apo edhe të strukturave të saj të varësisë, ka përmbledhur raste specifike, të cilat mund të shërbejnë si referencë për tatimpagues të ndryshëm në trajtimin e një sërë problemesh që kanë të bëjnë me zbatimin e legjisllacionit tatimor, me procedurat tatimore apo edhe me çështje dhe raste praktike.

Referuar sa më sipër, ky Buletin, është një përmbledhje e sqarimeve, opinioneve dhe udhëzimeve, që kanë unifikuar qasjen e administratës tatimore kundrejt tatimpaguesve dhe përfshin periudhën nga 1 Janari 2018 deri në 30 Qershor 2018.

Ky Buletin në logjikën e buletineve të mëparshëm është i organizuar në 3 kapituj, të cilët respektivisht janë ndarë në kapitullin hyrës, në kapitullin II, në të cilin përfshihet një sqaruese/orientuese që u drejtohet Drejtorive Rajonale, por që u shërben edhe tatimpaguesve që ushtrojnë veprimtari në strukturat akomoduese në lidhje me përmbushjen ligjore për ndarje të aktivitetit dhe së fundi është edhe kapitulli III, i ndarë nga ana e tij në katër nënçështje dhe në të cilin respektivisht janë përfshirë raste praktike nga ligji i procedurave tatimore dhe ligjet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

e tjera specifike, sikundër janë ligji i tatimit mbi të ardhurat, ligji i tatimit mbi vlerën e shtuar dhe kuadri ligjor i sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

II. UDHËZIM TEKNIK - Sqarim lidhur me ndarjen e e veprimtarive ekonomike e për tatimpaguesit që aplikojnë shkallën e reduktuar të T.V.SH-së 6%.

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ / ____ /2018

Lënda: Sqarim lidhur me ndarjen e e veprimtarive ekonomike e për tatimpaguesit që aplikojnë shkallën e reduktuar të T.V.SH-së 6%.

DREJTORISË RAJONALE TATIMORE

Nisur nga shqetësimi i tatimpaguesve të cilët operojnë në fushën e akomodimit dhe të turizmit, në lidhje me zbatimin e paragrafit 2, të nenit 11/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr.92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, sipas të cilit përcaktohet se, për qëllime të veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese, me qëllim aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së, personat e tatueshëm, të cilët, përveç veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese, kryejnë edhe veprimtari të tjera, regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit si persona të tatueshëm më vete, duke riorganizuar ose jo veprimtarinë e tyre ekonomike, siç përcaktohet në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi”, administrata tatimore në përmbushje të misionit të saj si dhe mbështetur në parimet e administrimit tatimor të përcaktuar në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për një zbatim të njëjtë dhe efektiv të legjislacionit tatimor orienton si me poshtë dy çështje për t'u rikonsideruar:

Në funksion të përcaktimit të modaliteteve dhe kushteve të regjistrimit të personave të tatueshëm që ushtrojnë veprimtari në fushën e strukturave akomoduese, bazuar në pikën 1 të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

nenit 11/1 të VKM nr.652, datë 10.11.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, e cila referon që strukturat akomoduese ushtrojnë veprimtarinë sipas legjislacionit në fushën e turizmit, duhet t’i referohemi këtij të fundit për të sqaruar së pari se çfarë është një strukturë akomoduese.

Kështu sipas neni 4 pika 33 e ligjit për turizimin, sqarohet koncepti i strukture akomoduese, me të cilën kuptohet: *“Struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera), në përputhje me standardet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj”.*

Pra, i rëndësishëm është fakti që njësitë e shërbimit të tipit restorante, bare, salla konferencash, sallë fitnesi, pishina, park lojrash, apo shezlongje në rastin e resorteve etj, të jenë në shërbim të strukturave akomoduese dhe brenda njësisive akomoduese apo kompleksit si një e tërë duke faturuar TVSH-në sipas shkallës tatimore që u takon dhe duke zbatuar kushtet e përcaktuara dhe parashikimet në Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin përkatës, në lidhje me procesin e regjistrimit.

Përsa i përket përcaktimit ligjor të parashikuar në paragrafin 2 të nenit 11/1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr.92/2014, Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, se, për qëllime të veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese, me qëllim aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së, personat e tatueshëm, të cilët, përveç veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese, kryejnë edhe veprimtari të tjera, regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit si persona të tatueshëm më vete, duke riorganizuar ose jo veprimtarinë e tyre ekonomike, siç përcaktohet në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, sjellim në vëmendje se, nëse personi i tatueshëm ushtron dhe veprimtari të tjera përveç asaj të strukturave akomoduese, duhet të regjistrohet si person i tatueshëm më vete. Me veprimtari të tjera kuptohet kur subjekti përveç veprimtarisë në fushën e akomodimit, ushtron edhe aktivitete të tjera si psh ndërtim, tregti, energjitiqë etj. Në një rast të tillë ky tatimpagues duhet të ndajë më vete veprimtarinë ekonomike në fushën e akomodimit dhe hotelerisë me aktivitetin tjetër që ushtrohet jashtë veprimtarisë akomoduese apo që është jashtë terësisë së shërbimeve që i shërbejnë njësisë akomoduese sipas konceptit të fushës së turizmit, si më lart të shpjeguar. Kjo bëhet në mënyrë që të identifikohet qartë aktiviteti që ushtrohet në fushën e strukturave akomoduese dhe që përfiton nga shkalla tatimore 6 % TVSH me aktivitetin tjetër që ushtrohet me shkallë standarte të TVSH-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Duke iu referuar dispozitave ligjore të ligjit nr.9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të gjithë subjektet që ushtrojnë një veprimtari ekonomike regjistrohen në regjistrin tregtar në një nga format e parashikuara në këtë ligj dhe sipas mënyrës së parashikuar në ligjin 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, ndryshuar.

Sipas ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, subjektet regjistrohen si:

- Tregtarë, të cilët janë persona fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil dhe që ushtrojnë veprimtari ekonomike të pavarur,
- Në formën e një shoqërie tregtare (kolektive, komandite, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëri aksionere).

Me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në një nga format e mësipërme, subjektet pajisen me numër identifikimi unik, të gjenruar elektronikisht, i cili shërben si numër identifikimi tatimor i tyre për tatimet kombëtare dhe vendore.

III. RASTE SPECIFIKE TË TATIMPAGUESVE TË TRAJTUARA PËR PROBLEMATIKA TË HASURA NË PRAKTIKË

1. Nga fusha e procedurave tatimore

1.1 *Mbi përdorimin e faturës së shoqërimit gjatë lëvizjes së brendshme të mallrave si dhe lidhur me pajisjen e mjeteve të transportit me Nipt sekondar.*

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ / ____ /2018

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës tuaj, datë _____ me lëndë “Kërkesë për sqarim” protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me nr. _____ sqarojmë si më poshtë:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” në nenin 46 “Mbajtja e të dhënave” dhe në udhëzimin Nr.24 datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 46.1.9 ka përcaktuar se, personi i tatueshëm, për çdo lëvizje të brendshme të mallrave nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

magazina në magazinë, nga magazina në dyqan apo anasjelltas, nga qendra në filial, nga vendi i prodhimit në magazinë, nga vendi i prodhimit në dyqan, etj, është i detyruar të lëshojë faturën e shoqërimit të mallit.

Pra, dhe në rastin kur kompania juaj do të kryejë përpunimin e letrës, nga një tatimpagues tjetër, në momentin kur kryeni daljen nga magazina të letrës atëherë, duhet që të prisni faturën e shoqërimit të mallrave me qëllim përpunimin e saj, mbasi letra është përpunuar nga tatimpaguesi tjetër, ky i fundit është i detyruar të lëshojë faturën tatimore të shitjes për shërbimin e ofruar bazuar kjo në referencat ligjore të përmëndura më sipër.

Lidhur me pajisjen e mjeteve të transportit me Nipt sekondar bazuar në Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 43 “Përditësimi i të dhënave” dhe në udhëzimin Nr 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikat 43.4.1, 43.4.3, ju bëjmë me dije se, për mjetet e transportit të mallrave, qëllimi i përdorimit të të cilëve është, transporti i mallrave për lëvizje të brendshme, si ato nga magazina në magazinë, nga magazina në dyqan apo anasjelltas, nga qendra në filial, nga vendi i prodhimit në magazinë, nga vendi i prodhimit në dyqan, nga dogana ku zhdoganohet malli në drejtim të magazinës së personit të tatueshëm importues ose transporti i mallrave me destinacion nga një tatimpagues te një tjetër, i kryer me mjetet e njërës prej tatimpaguesve, shitësit ose blerësit, atëherë dokumenti që përdoret për të vërtetuar përdorimin e mjetit në funksion të veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit, është vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku tatimpaguesi është i regjistruar. Tatimpaguesi pajiset me vërtetim për çdo mjet që ai ka në pronësi dhe ka në grupin e aktiveve të pasurisë, sipas pasqyrave financiare të deklaruara prej tij.

Ndërsa për mjetet e transportit të mallrave, qëllimi i lëvizjes së të cilëve është shitja derë më derë, për klientët, mjetet e transportit të mallrave, që i përkasin personave të regjistruar për kryerje aktiviteti transport mallrash, duke u konsideruar adresa ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij, si dokument vërtetues i përkatësisë së mjetit është çertifikata e regjistrimit të personit të tatueshëm, me numër të ndryshëm serial (ose quajtur ndryshe “NIPT-i sekondar”), e lëshuar për çdo mjet që kryen veprimtari në të tilla kushte.

1.2. Mbi dokumentacionin tatimor që duhet të disponojnë organizatat jofitimpruese për llogaritjen, mbajtjen, dhe kontabilizimin e informacionit tatimor.

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ / ____ / 2018

Lënda: Kthim përgjigje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Në përgjigje të shkresës tuaj me lëndë “Kërkesë për interpretim”, përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me shkresën nr._____, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr._____, sqarojmë si më poshtë:

Sipas përcaktimit ligjor të nenit 58 “*Dokumentimi i mallrave*”, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 46.1.11 është përcaktuar se, tatimpaguesit që mbajnë, tregtojnë, përdorin ose transportojnë

mallra, duhet të kenë dokumentet e nevojshme tatimore, që provojnë pronësinë ose kontrollin mbi këto mallra dhe, me kërkesën e zyrtarëve të administratës tatimore, i vënë këto dokumente në dispozicion të tyre.

Gjate ushtrimit të veprimtarisë për të cilën janë krijuar, organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, mund të kryejnë furnizim mallrash apo shërbimesh si dhe të marrin pagesa për arsye të tjera të ndryshme. Në këto raste ato lëshojnë faturë të thjeshtë tatimore, me përjashtim të rasteve kur në bazë të legjislacionit tatimor në fuqi janë të detyruar të lëshojnë faturë me TVSH.

Çdo tatimpagues, është i detyruar të mbajë regjistrat, librat dhe skedarë elektronikë ose manualë që përmbajnë informacionin financiar të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të veprimeve tregtare e biznesore të tatimpaguesit, në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe legjislacionin tatimor.

Pavarësisht formës juridike të organizimit, një nga detyrimet që ju lind është dhe llogaritja, mbajtja, dhe kontabilizimi i të gjitha transaksioneve që kryhen nga kompania juaj bazuar kjo në ligjin Nr 9228 datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, në vendimin Nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 4 “Manifestimet e kryera nga organizatat jofitimprurëse për qëllime bamirësie ose mbështetje të shtresave në nevojë” është përcaktuar se, në zbatim në shkronjës “i”, të nenit 51, të ligjit, furnizimi i shërbimeve dhe mallrave të kryera nga organizatat jofitimprurëse, veprimtaria e të cilave përjashtohet nga TVSH-ja, në raste të manifestimeve ose organizimeve për mbledhje fondesh ekskluzivisht për qëllime bamirësie ose në funksion të përmbushjes së qëllimit të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, përjashtohen nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

TVSH-ja nëse numri i këtyre manifestimeve nuk kalon 5 (pesë) të tilla në vit. Nëse organizohen më shumë manifestime të tilla, përjashtimi nga TVSH-ja aplikohet për të ardhurat e mbledhura vetëm për 5 (pesë) manifestime.

Sa më sipër mbetet një trajtim në parim i çështjeve të parashtruara nga ju, zbatimi korrekt i dispozitave të legjislacionit tatimor në fuqi përgjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike mbetet në përgjegjësinë tuaj.

1.3. Mbi përgjegjësinë tatimore të TVSH-së në bazë të qarkullimit vjetor.

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës tuaj datë ____ me lëndë “Kërkesë për interpretim”, protokolluar me tonën Nr. _____, ju sqarojmë se:

Në bazë të ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 23, parashikohen mënyrat e komunikimit të administratës Tatimore me tatimpaguesit. Në pikën 3 të nenit të sipërcituar përcaktohet se, çdo korrespondencë që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore, konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik dhe të postës rekomande.

Në kuadër të të drejtave të tatimpaguesit, kreu IV, në nenin 38, parashikohet se tatimpaguesi gëzon të drejtën të ankohet dhe të sigurohet për një shqyrtim të pavarur administrativ të çështjeve të lidhura me të. Përsa parashtroni në shkresën tuaj, kjo e drejtë rezulton të jetë ezauruar dhe për të cilën ju keni marrë një përgjigje nga institucioni përkatës i Drejtorisë së Apelit Tatimor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Përsa i përket përgjegjësisë tatimore, të cilës tatimpaguesi duhet t'i nënshtrohet, në nenin 119 të ligjit Nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar, përcaktohet se "Qarkullimi që shërben për zbatimin e regjimit, sipas nenit 117, të këtij seksioni, përfshin qarkullimin e realizuar nga të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve, përfshirë furnizimet e kryera sipas neneve 57, 59, 60, 61 dhe 62, të këtij ligji, të kryera nga i njëjti person i tatueshëm dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi, pa përfshirë TVSH-në".

Gjithashtu neni 120 i ligjit të sipërcituar parashikon të drejtën e zgjedhjes së regjimit të TVSH-së kur:

1. Personi i tatueshëm, pavarësisht se nuk plotëson kriteret për aplikimin e këtij regjimi ose e zbaton atë, ka të drejtë të zgjedhë të zbatojë regjimin normal të TVSH-së.
2. Personi që zgjedh të jetë i regjistruar për TVSH-në, sipas pikës 1, të këtij neni, detyrohet të qëndrojë dhe t'i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së jo më pak se 2 vjet kalendarikë.
3. Personi i regjistruar për TVSH-në, sipas këtij neni, ka të drejtë të kërkojë t'i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla dhe ç'regjistrimi i tij nga regjimi normal i TVSH-së hyn në fuqi 6 muaj pas datës së paraqitjes së kërkesës.

Ndërkohë në nenin 6 të Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se, personi i tatueshëm i regjistruar në regjimin normal të TVSH-së, ka të drejtë të kërkojë të ç'regjistrohet nga TVSH në rastet kur:

- a) Personi i tatueshëm mbyll veprimtarinë e tij ekonomike.
- b) Personi i tatueshëm ka plotësuar kushtet dhe procedurën për t'iu nënshtuar regjimit të bizneseve të vogla, siç përcaktohet në këtë udhëzim.
- c) Personi i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në nuk ka qenë asnjëherë i detyruar të jetë i regjistruar dhe as nuk e ka ushtruar vullnetarisht të drejtën e zgjedhjes për t'u regjistruar për TVSH-në.

Për sa sipër, kërkesa për çregjistrimin e personit të tatueshëm për rastet b) dhe c) i drejtohet Drejtorisë Rajonale Tatimore, e cila kryen procedurën përkatëse. Autoriteti tatimor ka detyrimin ligjor që pasi personi i tatueshëm të jetë çregjistruar nga regjimi normal i TVSH-së, të njoftojë brenda tre ditëve kalendarike Qendrën Kombëtare të Biznesit për ndryshimin dhe evidentimin e këtij ndryshimi në regjistrin tregtar, përsa ka të bëjë me ndryshime në regjistrim.

Gjithashtu sjellim në vëmendje se, në nenin 7 të udhëzimit të sipërcituar, parashikohet se, çdo person i tatueshëm që çregjistrohet ose kërkon të çregjistrohet nga TVSH-ja ka mallra të pa-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

shitura dhe mbi këto mallra, TVSH-ja ka qenë tërësisht apo pjesërisht e zbritshme, këto mallra do të konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës dhe personi i tatueshëm është i detyruar të llogarisë ose rregullojë TVSH-në për këtë furnizim.

Së fundi, bazuar në nenin 64 dhe 67 të ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, tatimpaguesi dorëzon deklaratën tatimore të plotë dhe të saktë brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor përkatës. Ndërkohë, brenda 36 muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare, tatimpaguesi mund të dorëzojë deklaratë të re tatimore, me ndryshime, në rastet kur konstatohet se deklarata tatimore fillestare është e pasaktë dhe me mangësi.

2. Nga fusha e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar

2.1. Mbi përjashtimin nga TVSH-ja për furnizimin e shërbimeve arsimore.

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ / ____ / 2018

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës tuaj datë _____ me lëndë “Kërkesë për sqarim”, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr. _____, ju sqarojmë se:

Sipas përcaktimit ligjor të nenit 2 “Fusha e zbatimit”, të Ligjit Nr.92/2014, datë 27.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë si edhe të gjitha importet e mallrave në territorin e R.SH, përveç kur përjashtohen nga TVSH-ja sipas ligjit, përcaktim ky i rëndësishëm, për qëllime të aplikimit të tatimit mbi vlerën e shtuar në transaksionet midis palëve.

Bazuar në pikën g, të nenit 51 “Përjashtimi i disa veprimtarive në interes të përgjithshëm” të ligjit Nr.92/2014, datë 27.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 39 “Përjashtimi nga TVSH për furnizimin e shërbimeve arsimore” është përcaktuar se, përjashtimi zbatohet për furnizimet e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

mirëfillta të mësimdhënies shkollore, universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit, përfshirë furnizimin e shërbimeve ose të mallrave të lidhura ngushtë me këtë mësimdhënie.

Është kusht që të jenë të përjashtuara, përveç se duhet të jenë shërbime të edukimit dhe mësimdhënies në të gjitha nivelet, shërbimet duhet të jenë të furnizuara nga institucione arsimore të njohura si të tilla, pavarësisht nëse janë shërbime arsimore ose shërbime dhe mallra të lidhura ngushtësisht me to.

2.2 Mbi saktësinë e vlerës së tatueshme-Rastet e lëshimit të faturës korigjuese.

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2018

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës tuaj, Nr.17/04 Prot., datë 16.04.2018 me lëndë “Kërkesë për informacion”, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr.8147 Prot., datë 19.04.2018, sqarojmë si më poshtë:

Bazuar në nenin 41 të ligjit të Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015 “Për TVSH në RSH”, të ndryshuar, nenit 32 “Saktësimi i vlerës së tatueshme”, janë parashikuar rastet kur lejohet të bëhet një saktësim vlerës së tatueshme prej furnizuesit të mallit ose shërbimit, në rast anulimi, tërheqje, zgjidhjeje dhe reduktimi i çmimit që bëhet pas momentit të kryerjes së furnizimit.

Për qëllime të kryerjes së saktësimi, furnizuesi do të lëshojë një faturë korigjuese - notë krediti nëse korigjon në ulje vlerën e faturës fillestare ose faturë korigjuese - notë debiti nëse korigjon në rritje vlerën e faturës fillestare.

Kur ulja përfitohet në momentin e furnizimit ajo pasqyrohet në faturën e lëshuar nga furnizuesi për furnizimin, duke treguar edhe vlerat përkatëse fillestare dhe ato pas uljes. Furnizuesi dhe blerësi regjistrojnë faturën në librat përkatës duke marrë parasysh edhe uljen ose reduktimin e vlerës në momentin e furnizimit. Në këtë rast nuk duhet të zbatohet faturë korigjuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Në rastin kur ulja përfitohet më vonë, jo në momentin e furnizimit, por e kushtëzuar me datën kur do të kryhet pagesa apo çdo kusht tregtar tjetër, që të merret parasysh reduktimi i vlerës së tatueshme të furnizimit në momentin kur kushti plotësohet prej blerësit ose klientit duhet që ky fakt të jetë evidentuar (shkruar) në faturë në momentin e furnizimit prej furnizuesit.

Në momentin që përfitohet ulja, moment i cili mund të jetë në një periudhë tjetër tatimore furnizuesi lëshon një faturë tatimore me TVSH (notë krediti) për blerësin ose klientin duke evidentuar në të:

- dukshëm shënimin “*faturë korigjuese- notë krediti*”;
- të dhënat e faturës që korigjon si Nr. fature, Nr. serial, datë, etj.;
- vlerat saktësuese përkatëse përkatësisht në rastin e një ulje duhet të jenë me vlera negative;
- të shkruhet arsyeja e korigjimit të vlerës së furnizimit.

Kjo faturë regjistrohet prej shitësit në kutitë përkatëse të librit të shitjes si shitje me TVSH. Vlerat regjistrohen me shenjë negative dhe i zbriten vlerës së shitjeve dhe TVSH-së përkatësisht.

Blerësi nga ana e tij këtë faturë korigjuese e regjistron si vlerë negative në kutitë përkatëse të blerjeve me TVSH dhe ia zbret vlerës së blerjeve dhe TVSH përkatëse.

Në rastin kur lëshohet nota e kreditit, ajo duhet të përmbajë referencën e faturës fillestare dhe të tregojë shumën e uljes së miratuar, si dhe shumën e TVSH korresponduese.

Për të konsideruar të saktë procedurën e kryer kërkohet që:

- a) Fatura e re që anulon, zëvendëson ose korigjon të mëparshmen duhet të përmbajë referencën e saktë të faturës fillestare dhe shënimin e anulimit të kësaj të fundit. Përveç kësaj, ajo duhet të përmbajë tërësinë e informacioneve që përmban një faturë tatimore si dhe vlerat përkatëse tëkorigjuara.
- b) Në rastin kur lëshohet nota e kreditit, ajo duhet të përmbajë referencën e faturës fillestare dhe të tregojë shumën e uljes së miratuar, si dhe shumën e TVSH korresponduese.
- c) Përveç kësaj, nota e kreditit duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të palëve, si dhe vlerën e furnizimit dhe TVSH e detyrueshme pas zbatimit të reduktimit të çmimit. Të evidentohet qartë edhe vlerat përkatëse të zbritjes. Në të njëjtën kohë, klienti blerës i tatueshëm me TVSH, nëse e ka kryer zbritjen e TVSH që figuron në faturën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

fillestare, është i detyruar të reduktoje (ulë) shumën e kësaj zbritje sipas shumës së tatimit që figuron në notën e kreditit.

2.3. Rastet e përjashtimit nga TVSH-ja përa i përket furnizimit të tokës, ndërtesës dhe dhënia me qira e pasurive të paluajtshme.

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2018

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës tuaj, datë _____, me lëndë “Kërkesë për interpretim”, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me _____, sqarojmë si më poshtë:

Në nenin 53 “Përjashtime për disa përjashtime të tjera” pika “h” të Ligjit Nr.92/2014, datë 27.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 44 “Furnizimi i tokës, ndërtesës dhe dhënia me qira e pasurive të paluajtshme”, është përcaktuar se, janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, përveç:

- dhënies me qira të ndërtesave për një periudhë deri në dy muaj.
- strehimit në hotele ose vende pushimi, të kryera në sektorin e hotelerisë ose në sektorë që kanë funksione të njëjta, përfshirë qiradhënien e kampeve të pushimit apo të terreneve të pajisura për kampingje;
- dhënien me qira të zonave të destinuara për parkimin dhe magazinimin e automjeteve dhe mjeteve të tjera lëvizëse;
- dhënien me qira të pajisjeve dhe makinerive të fiksuara në mënyrë të qëndrueshme;
- dhënien me qira të kasafortave.

Ndërkohë, në nenin 45 “Ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimet e përjashtuara” të UMF Nr.6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është përcaktuar se, pavarësisht nga trajtimi si furnizim i përjashtuar nga TVSH i qiradhënies së ndërtesave mbi 2 muaj, i parashikuar në nenin 53, pika “h” të ligjit, personi i tatuueshëm që kryen veprimtari të qiradhënies së ndërtesës gëzon të drejtën e zgjedhjes për ta trajtuar qiradhënien e ndërtesave si furnizim të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

tatueshëm me TVSH 20%. Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet për qiradhënien e ndërtesave për banim.

Pra, referuar përmbajtjes së shkresës tuaj, dispozitat ligjore të lartpërmëndura kanë përcaktuar qartë mënyrën se si do të operojnë tatimpaguesit lidhur me qiradhënien ose nënqiranë dhe të drejtën e zgjedhjes së aplikimit të T.V.SH-së.

Sa më sipër mbetet një trajtim në parim i çështjeve të parashtruara nga ju, zbatimi korrekt i dispozitave të legjislacionit tatimor në fuqi përgjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike mbetet në përgjegjësinë tuaj.

3. Nga fusha e ligjit të Tatimit mbi të Ardhurat

3.1. *Mbi njohjen si shpenzim i zbritshëm të vlerës së truallit të vënë në dispozicion nga pronari i tokës, sipas kontratave të këmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi.*

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës tuaj datë _____ me lëndë “Interpretim ligjor i rastit”, protokolluar me tonën nr. _____ prot., datë _____ sqarojmë se:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 20 “Shpenzime të njohura” përcaktohet se, për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes së ndërtesave me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, njihet si shpenzim i zbritshëm edhe vlera e truallit të vënë në dispozicion nga pronari i tokës, sipas kontratave të këmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi.

Metodika e përcaktimit të vlerës së truallit për m² miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe bazohet në koston minimale fiskale të ndërtimit, sipas qyteteve apo zonave brenda qyteteve. Për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, në të ardhurat e tatueshme të investitorit llogariten edhe të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

ardhurat që i korrespondojnë pjesës së sipërfaqes së ndërtimit që përfitojnë pronarët e truallit për rastet e kontratave të këmbimit truall-sipërfaqe ndërtimi.

Vlerësimi i të ardhurave për pjesën e pronarit të truallit bëhet në të njëjtën mënyrë si për pjesën e të ardhurave të realizuara nga investitori dhe ai bazohet në metodikën e miratuar nga Këshilli i Ministrave lidhur me fitimin minimal fiskal.

Në VKM nr.1129, datë 5.8.2008 “Për mënyrën e përcaktimit të vlerës së truallit të vënë nga pronarët e tij, në dispozicion të investitorëve të ndërtimit” përcaktohet se, vlera e truallit për m² të vënë nga pronarët e truallit (tokë), në dispozicion të investitorëve të ndërtimit për veprimtari ndërtimi, për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, përkundërt përfitimit në natyrë të sipërfaqeve të ndërtimit, llogaritet në këtë mënyrë:

- a) Sipërfaqja e ndërtimit, në m², që përfitojnë pronarët e truallit përcaktohet në bazë të kontratës së shkëmbimit të pasurisë truall me ndërtesën e ngritur mbi të;
- b) Kosto e ndërtimit, për m², përcaktohet në bazë të kostos minimale fiskale të ndërtimit, sipas qyteteve apo zonave brenda qyteteve;
- c) Vlera e truallit, të vënë në dispozicion nga pronari, llogaritet si prodhim i kostos së ndërtimit, për m², me pjesën e sipërfaqes së objektit, që kanë përfituar pronarët.

Vlera e truallit (tokë), e llogaritur si më sipër, është shpenzim i zbritshëm për investitorin e objektit.

Gjejmë me vend t’ju bëjmë me dije se, një nga parimet themelore të administrimit tatimor është vetëvlerësimi dhe vetëdeklarimi i detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit si dhe zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore.

Ndërkohë, zbatimi korrekt i dispozitave të legjislacionit tatimor në fuqi mbetet në përgjegjësinë e tatimpaguesit.

3.2. Mbi tatimin që i nënshtrohen të ardhurat e individit në rastin eshpërndarjes së dividendit.

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2018

Lënda: Kthim përgjigje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Në përgjigje të shkresës tuaj datë ____me lëndë “Kërkesë për interpretim ligjor për dy çështje” protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me nr.____, ju informojmë si vijon:

1. Në lidhje me tatimin e të ardhurës për personin fizik me përgjegjësi tatimore të tatimit mbi fitimin, që rezulton pas tatimit mbi fitimin, në pikën 2.3.9 të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar përcaktohet se, të ardhurat e personit fizik tregtar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike taten vetëm sipas kreut III “Tatimi mbi fitimin” (nenet 16-32 të ligjit) në rastin e subjekteve me xhiro mbi 8 milionë lekë në vit dhe sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, për subjektet me xhiro deri në 8 milionë lekë në vit.

Personi fizik tregtar nuk ka personalitet juridik të ndryshëm nga individi, ndryshe nga rasti i shoqërive tregtare dhe ortakëve të saj individë dhe rrjedhimisht fitimi neto i personit fizik tregtar nuk konsiderohet si e ardhur personale e tatueshme e individit, sipas përcaktimit ligjor në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8, pika g.

2. Tatimpaguesit që kanë formën ligjore Sh.p.k, duhet të zbatojnë dispozitat ligjore fiskale në fuqi si dhe përcaktimet e dispozitave të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, në lidhje me fitimin pas tatimit.

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 8, pika 1 gërma b) si dhe në udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 (i ndryshuar), pika 2.3.3 përcaktohet se: “Janë të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale të ardhurat që

rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare. Në kuptim të kësaj pike, bëhet fjalë për të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividendit nga shoqëritë tregtare.”

Në të ardhurat e tatueshme sipas kësaj pike nuk përfshihet fitimi neto (fitimi pas pagimit të tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.

Përsa më lart cituam, tatimpaguesit që kanë statusin ligjor Sh.p.k pavarësisht nëse janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël apo subjekt i tatimit mbi fitimin, në rast se vendosin ndarjen e dividendit, atëherë të ardhurat që përfitojnë individët, duhet të taten sipas përcaktimeve të nenit 9, pika 2 të ligjit të sipërcituar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

3.3 Rastet kur nuk do të mbahet tatimi në burim.

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2018

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. ____ prot., datë _____ me lëndë “Kërkesë për interpretim”, protokolluar me tonën nr. _____ prot., datë _____, sqarojmë se:

Pika 5.2 e Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ka përcaktuar rastet kur nuk mbahet tatimi në burim. Kështu në gërmën e) të pikës 5.2 të Udhëzimit të mësipërm, përcaktohet se:

Tatimi në burim nuk do të mbahet kur pagesa i bëhet:

e) Çdo personi fizik ose juridik të huaj për shërbime që ata kryejnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të vërtetuara me dokumentacionin përkatës financiar e teknik. Degët e tatimeve kërkojnë interpretimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për trajtimin tatimor të këtyre shërbimeve.

Ky rregull përcakton disa kushte:

Së pari ofruesi i shërbimit të jetë një person fizik ose juridik dhe shërbimi të jetë ofruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Së dyti shërbimet e përfituara të vërtetohen me dokumentacionin përkatës financiar dhe teknik nga tatimpaguesi rezident shqiptar (paguesi i shumës), i cili duhet të disponojë gjithashtu çdo dokumentacion tjetër që ofruesi shërbimit ka përgatitur për këtë shërbim të ofruar. Pra, paguesi i shumës (tatimpaguesi rezident shqiptar), duhet të disponojë gjithë dokumentacionin financiar dhe teknik lidhur me faturimin dhe pagimin e shumës për shërbimin e ofruar si dhe të argumentojë domosdoshmërinë e këtij shpenzimi lidhur me aktivitetin biznesor të zhvilluar prej tij. Në rast se, tatimpaguesi provon përmbushjen e kushteve të mësipërme, atëherë ai është përfitues i kësaj dispozite.

Referuar përcaktimeve të kësaj pike, në çdo rast interpretimi në lidhje me trajtimin tatimor të shërbimeve financiare dhe teknike, kërkohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila verifikon dhe kontrollon zbatimin korrekt të dispozitave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

ligjore tatimore bazuar në dokumentacionin përkatës të vënë në dispozicion nga ana e tatimpaguesit.

4. Nga fusha e punësimit dhe sigurimeve Shoqërore

4.1. Rastet e përjashtimit të shtetasve të huaj nga mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2018

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës tuaj datë _____ me lëndë “Kërkesë për informacion”, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me nr. ____ prot., datë ____ ju informojmë se:

Në Vendimin 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar Kreu I “Kategoritë e personave të mbrojtur dhe të detyruar për t’u siguruar, sipas degëve e skemave të sigurimit”, pika 8 përcaktohet se, nga mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm shoqëror përjashtohen shtetasit e huaj që:

a) punojnë në subjekte të huaja, të cilat, në bazë të një marrëveshjeje, nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare;

b) janë të punësuar në subjekte të huaja, që nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët vijnë në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të kualifikuar, sipas një kontrate shërbimi, të lidhur me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor. Zgjatja e kohës së qëndrimit dhe shërbimit është sipas përcaktimeve në ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”;

c) janë të punësuar në subjekte të huaja, të cilat nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët dërgohen në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të caktuar, sipas një kontrate të lidhur nga subjekti i huaj punëdhënës me një subjekt të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor, kur plotësohen kushtet, si më poshtë vijon:

- i) Të ketë një marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, të lidhur midis shtetit shqiptar dhe shtetit të subjektit punëdhënës të huaj;
- ii) Procedura e regjistrimit, leja e punës dhe kohëzgjatja e saj të jenë kryer në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”;
- iii) Rezidenca dhe detyrimet për pagesë, sipas legjislacionit fiskal, të zbatohen sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9920, datë 9.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

iv) Subjekti kontraktues, i regjistruar në organet tatimore shqiptare, kërkon çdo 3 muaj, nga subjekti punëdhënës i huaj, dokument të konfirmuar nga strukturat e sigurimeve shoqërore të shtetit përkatës lidhur me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të shoqëruar me listën emërore të punonjësve të huaj, të cilën e administron së bashku me dokumentet e transfertave në favor të punëdhënësit të huaj.

ç) me rezidencë e banim të përhershëm jashtë territorit të Shqipërisë, të cilët kanë veprimtari të regjistruara në emrin e tyre në të dyja shtetet ku kryejnë detyrën e administratorit, së bashku me një administrator tjetër, me rezidencë të përhershme në Shqipëri. Në këtë rast, personat do të jenë subjekt i mbrojtjes dhe i sigurimit të detyrueshëm shoqëror në atë shtet ku kanë rezidencën dhe, njëkohësisht, të vërtetojnë me dokument mbrojtjen me sigurim shoqëror nga shteti përkatës. Rezidenca e ka kuptimin sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9920, datë 9.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) që janë të përjashtuar nga pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur midis shtetit të tyre me shtetin shqiptar.

Për sa më sipër, duhet t’i drejtoheni Institutit të Sigurimeve Shoqërore si institucioni përgjegjës për zbatimin e marrëveshjeve të lidhura midis shtetit shqiptar dhe shteteve të tjera (në rastin tuaj SHBA).

4.2 Mbi të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale - Përjashtimet nga paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2018

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. ____ prot., datë ____ me lëndë “Kërkesë për interpretim”, protokolluar me tonën nr. ____ prot., datë ____ sqarojmë se:

1. Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 8, pika 1, gërma a) përcaktohet se, të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale.

Në pikën 2.3 të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 (i ndryshuar) në zbatim të dispozitave ligjore citohet: Në të ardhurat nga pagat përfshihet paga bazë si dhe të gjitha shtesat mbi pagën bazë që kanë karakter të përhershëm si shtesat për vjetërsi, vështirësi, largësi vendbanimi, natyrë të veçantë pune apo shërbimi, si dhe shtesa të tjera page e shpërblimi të bëra me akte të tjera ligjore e nënligjore.

Termi “shpërblime të tjera” përfshin të gjitha të ardhurat apo shpërblimet që përfitohen nga rezultatet e punës në vendin e punësimit aktual të individit.

Në këtë kategori bëjnë pjesë të ardhurat që merr individi në formë shpërblimi nga fondi i veçantë, apo nga fonde të krijuara me akte të ndryshme ligjore apo statutore të shoqërive, si pagë e 13-të, apo pagesa të ndryshme të kësaj natyre

2. Në kreun II “Paga për efekt të llogaritjes së kontributeve” të Vendimit Nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” përcaktohet se, paga bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të

është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi, ose në kontratën e punës sipas rastit, me kohë ose vëllim pune dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës.

Paga bruto evidentohet në listëpagesën tip, e cila është deklaratë për pagesë dhe dokumenti bazë për evidentimin e kontributeve individuale.

Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor, nuk përfshihen:

- a) përfitimet që punëmarrësi merr nga fondet e sigurimeve shoqërore;
- b) kompensimet nga rritja e çmimeve;
- c) dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

- ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykatë;
- d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë, për personat e punësuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundjet e gjata, për dëme, në raste fatkeqësish të mëdha natyrore, dhe për veprimtari të shquara;
- e) vlera e shpenzimeve për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit, të cilat jepen bazuar në legjislacionin në fuqi dhe që nuk janë pjesë e pagës;
- ë) honorarët apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

Për sa më sipër, të ardhurat që përfitohen nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil”, i ndryshuar janë të ardhura me karakter të përhershëm dhe konsiderohen të ardhura paga, të cilat i nënshtrohen si tatimit mbi të ardhurat personale ashtu edhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Tiranë, më 31.07.2018